

# STEBLEVA



GAZETË E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nr.29. 6 Maj 2014.

Çmimi 50 lekë.

## Masa të reja për turizmin

### Editorial


#### Strategji afatgjatë për turizmin e Steblevës

Komuna Stebleve ndodhet në veri-lindje të Librazhdit dhe përbëhet nga 7 fshatra: Steblevë, Zabzun, Borovë, Llangë, Sebisht, Moglicë dhe Prodan.

Sot komuna ka rreth 2 300 banorë dhe ka një shtrirje totale territoriale rreth 119.5 km<sup>2</sup>. Ajo ndodhet nën juridiksionin administrativ të Rrethit Librazhd të Qarkut Elbasan.

Kjo komunë ka një shtrirje të madhe gjeografike dhe territoriale dhe është zona më e lartë e populluar e vendit tonë. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 1200 m. Komuna Steblevë dëshmohej si një vendbanim prehistorik (duke iu referuar gjurmëve të gjetura si Greshkameni i Borovës). Para vitit 1990 Stebleva ka patur mbi 900 shtëpi dhe mbi 4500 banorë. Pra popullimi i zonës ka qenë si rezultat i një kulture të qëndrueshme në blegtori, bujqësi, tregëti, ndërtim etj.

(Vijon në faqen 2)



Lexoni në faqen 2-3

#### GOLLOBORDA dhe Trebishti në 100 vjetorin e shkollës shqipe

Mehmet HASANI

Në historinë e përpjekjeve dhe të sakrificave për identitet kombëtar, Golloborda, si pjesë e Dibrës, ka dhënë kontributin e vet që e bën krenare në këtë 100 vjetor të gjuhës shqipe në Trebisht.

Ky kontribut fillon që në kohën e Skënderbeut, kulmon me shpalljen e Pavarësisë e në vecanti për mbrojtjen e tërësisë territoriale prej djegjeve e masakrave serbe në vitet 1912-1922, vazhdon me rezistencën aktive ndaj pushtesit nazi-fashist duke e shkruar kështu historinë e vet me gjak e duke qenë krenare...



Faqe 5

#### FALENDERIM

Falenderojme Dr. Dilaver Abazi, nënkryetar i Shoqatës Stebleva për sponsorizimin e këtij numri të gazetes Stebleva



**SHOQAT  
STEBLEVA**

Mersin HOXHA  
Kryetar

Rr. "Xhon Belushi" Vila 519, prapa Fizikës Bërthamore Tiranë  
Cel. 069 51 68 173 / 069 66 16 101  
E\_mail: mersin\_hoxha@yahoo.com  
Web: www.shoqatastebleva.com

**TRINITY TRADE  
COMPANY**

Rruga "Reshit Çollaku", pall. 15  
katësh, shkalla I, kati 2, ap.1.  
Tiranë

Në këtë numër  
do të lexoni

STEBLEVA DJEP I  
KULTURËS DHE  
PATRIOTIZMIT MASIV

Nga Velo CFARKU

FAQE 4

LËVIZJA DEMOGRAFIKE,  
EKONOMIKE DHE  
TRADICIONALE E  
FSHATIT STEBLEVË  
NDËR VITE

nga Ferit BUSHATI

FAQE 6

70 VJET ARSIM  
NË VIÇISHT

Nga Shpëtim CAMI

FAQE 3

KISHAT  
ORTODOKSE TË  
TREVËS SË  
GOLLOBORDËS

Nga Pavli Nikolla

FAQE 7

NJË EMËR QË  
NDERON STEBLEVËN

Nga Zaim LILA

FAQE 7

ORANIK!


Nga Nexhi BAUSHI

FAQE 7

SALI MUSTAFA  
HOXHA

Ing. Enver KOÇI

FAQE 6





# Strategji afatgjatë për turizmin e Steblevës

(Vijon nga faqja 1)

Stebleva ashtu si gjithë zona e Gollobordës ka të ngjashme traditat dhe kulturën, dhe ashtu si të gjithë gollobordasit, njihet historikisht për mjeshtërinë e ndërtimit. Mjeshtërit gollobordas njihen jo vetëm në Shqipëri por dhe më gjërë, në Ballkan, Turqi, Bullgari, etj, për artin dhe kulturën e tyre të veçantë të të ndërtuarit.

Pas vitit 1990, falë intelektit, mjeshtërisë në ndërtimtarë, falë traditës dhe kulturës së punës ata u përshtatën mjaft mirë me ekonominë e tregut dhe u bënë të suksesshëm në fushën e biznesit dhe të tregtisë.

Megjithë kushtet e mrekullueshme natyrore dhe klimaterike periudha e ndryshimeve politike në rang kombëtar dhe ndryshimi i sistemit krijuan kushtet për lëvizjen e lirë dhe pa kriter të popullsisë në mbarë Shqipërinë duke prekur ndjeshëm dhe Komunën e Steblevës, ku pati një rrjedhje të ndjeshme të popullsisë drejt zonave urbane apo në emigracion, por ndryshe nga zona të tjera të Shqipërisë, karakteristike për këtë zonë ishte fakti se banorët e Steblevës nuk u larguan përgjithmone, ata nuk shitën pasuritë e tyre të paluajtshme duke menduar se një ditë do të riktheheshin në vendlindjen e tyre për të jetuar, punuar ose për të shijuar bukuritë e pafundme natyrore. Ky grup përbën edhe numrin më të madh të turistëve vendas që e vizitojnë zonën, përpos turistëve që vijnë nga rrethet e tjera të qarkut, kryesisht qytetit të Elbasanit, si dhe një numri aktualisht të vogël turistësh të huaj që e frekuentojnë zonën për bukuritë e saj të mahnitshme dhe kulturën e pasur. Katër publikime ndërkombehtarë, dhjetë nga Ministria e Turizmit, broshura, harta guida, publike nga rajoni, pesë publikime nga sektori privat i turizmit shqiptar, të gjitha janë riparë për të përcaktuar se si zona e Steblevës paraqitet dhe promovohet për turistët potencialë. Fatkeqsisht, kjo zonë merr shumë pak vëmendje. Përjashtim bëjnë vetëm broshurat dhe guidat rajonale ku zona përmendet për bukuritë natyrore dhe atraksionet kulturore.

Oferta turistike:

Për t'i ardhur në ndihmë planifikimit për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit

në Steblevë dhe për identifikimin e tregjeve kryesore, u krye një shqyrtim i ofertës turistike ekzistuese. Analiza e ofertës u përqëndrua në akomodimin, shërbimin e ushqimit dhe pijeve, objekteve, aseteve turistike, aktivitete dhe festivale.

Akomodimi:

Në vitin 2011, Stebleva kishte 1 hotel me 30 shtetë, i cili ndodhet në qendër të komunës dhe 10 shtëpi pritëse me 20 dhoma dhe 40 shtetë. Zënia e

hotelit dhe shtëpive të pritjes për momentin është në masën 30%. Duke parë

fluksin në rritje të turistëve të huaj, numri i shtëpive pritëse duke ndjekur karakteristikat e ndërtimit të zones, ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit.

Ushqimi:

Në Steblevë ka rreth 11 restorante dhe 10 shtëpi pritëse që u shërbejnë turistëve. Kryesisht ofrohet kuzhinë tradicionale, me bazë patatën që është edhe mbretëresha e ushqimit të kësaj zone. Për shkak të terrenit të favorshëm, blegtoria është e zhvilluar e për rrjedhojë edhe mishit apo nën produktet e qumështit janë me shije të vecantë dhe organike.

Festivalet dhe aktivitetet:

Një vlerë e vyer e trashëgimisë kulturore të zonës janë festimet kolektive tradicionale të zonës në periudha të ndryshme të vitit si festa e Shëngjergjit etj. Në këto takime kolektive dalin në pah traditat e veçanta të trashëguara brez pas brezi si në sjellje, gjuhë, veshje, muzikë dhe kulturë, duke i zhvilluar këto tradita si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë historike e kulturore. Në këto evenimente grumbullohen përveç banorëve të zonës dhe ish banorët e saj, të cilët kanë imigruar apo emigruar prej kohësh, duke ringjallur dhe mbrojtur kështu elementet e traditës. Një pasuri e madhe e trashëgimisë kulturore e zonës është larmia e kostumeve popullore e tradicionale sipas zonave dhe fshatrave, këngët dhe vallet karakteristike të zonës. Ekziston mundësia që këto aktivitete të promovohen si duhet për vizitorë të mundshëm si dhe të organizohen aktivitete të reja për të tërhequr sa më shumë vizitorë.

Shërbimet Turistike:

Stebleva aktualisht nuk ka një agjensi që ofron ture të organizuara në rajon. Turet për turistët organizohen sipas rasteve nga vetë banorët e zonës, të cilët rëndom bëjnë edhe shërbimin e guidës.

Objektet/atraksionet turistike:

Komuna e Steblevës ndodhet në vijën kufitare me Maqedoninë dhe 25 km larg qendrës më të afërt urbane, Librazhdin. Komuna e Steblevës ka një sipërfaqe tokë bujqësore prej 1260 ha por nga kjo tokë është shpërndarë rreth 460 ha tokë, kurse pjesa tjetër është lënë si tokë e pandarë për tokë buke. Ajo është kthyer në livadhe dhe kullota për blegtorinë. Komuna e Steblevës ka dhe një sipërfaqe të konsiderueshme kullotash e livadhesh si dhe pyjesh komunale dhe shtetërore dhe konkretisht 10000 ha pyje dhe kullota. Të gjitha këto i japin prioritet zonës për të zhvilluar bujqësinë e blegtorinë, si dhe turizmin malor për vetë hapsirën dhe kushtet që ka, si dhe në harmonizimin e të gjithë këtyre faktorëve për zhvillimin e agroturizmit në këtë komunë. Nga pikpamja territorial, e gjithë komuna e Steblevës dhe veçanërisht Fushë Studna është një territor me vlera të rralla si për pozitën gjeografike tepër të favorshme në gërshetim rrugësh me rëndësi kombëtare, ashtu dhe për bukurinë e mahnitshme që shpallon gërshetimi i elementëve të pasur natyrore si fusha, malet, zonat e pasura pyjore, lartësia mbi nivelin e detit tepër e variueshme, pasuria hidrike, flora dhe fauna, të pasura me specie dhe pothuajse e virgjër në shumicën e sipërfaqes së saj. Në shtirjen e kësaj komune hasën tipologji të ndryshme relievi, gjë që i bën fshatrat e saj të ndryshëm për nga karakteri dhe tipologjia. Kjo zonë është një "perle" natyrore me sipërfaqe të pamata pyjore të konservuara më së miri, me burime të shumta ujore, me gjelbërim në çdo stinë, resurse të virgjëra për investime në fushën e turizmit.

Asete historike, kulturore e tradicionale të zonës

Komuna Steblevë dëshmohej si një vendbanim prehistorik (duke iu referuar gjurmëve të gjetura si Greshkameni i Boroves). Stebleva ashtu si gjithë zona e Gollobordës kanë të ngjashme traditat dhe kulturën, dhe ashtu si të gjithë gollobordasit, njihet historikisht për mjeshtërinë e ndërtimit. Mjeshtërit gollobordas njihen jo vetëm në Shqipëri, por dhe më gjërë, në

Ballkan, Turqi, Bullgari, etj, për artin dhe kulturën e tyre të veçantë të të ndërtuarit.

**Nga pikpamja historike fshatrat përbërës të Komunës së Steblevës kanë**

karakteristikat e tyre të veçanta. Për të hyrë në Komunën Steblevë si portë hyrëse sapo zbrit nga shkalla e Lunikut, hasim fshatin Llangë, i cili shtrihet pjesërisht dhe brenda zonës sonë të studimit. Ky fshat shtrihet në një rrëzë mali në përrëndim të rrugës nacionale ku shpaloset një ansambël unik banesash të vjetra deri në 4 kate, krejt të veçanta në llojin dhe tipologjinë e tyre të ndërtimit. Këto banesa janë të ndërtuara me mure guri të trasha dhe dritare të vogla në formë frengjish (një tip midis kullës veriore dhe vilës gjirokastrite me hollin e përbashkët e të lartë që e ndan pothuajse godinën në dy seksione të njëjta. Në ndërtimin e tyre është shfrytëzuar pjerrësia natyrore e terrenit për të siguruar nënkartet e nëndeshme apo të poshtme, bazën ushqyese të blegtorisë. Në këtë zonë bie në pah kultura për shfrytëzimin e nikoqirllëk të parcelave të vogla përgjatë shtatit të malit. Karakteristike e këtij fshati janë dhe burimet me ujë të ftohtë përgjatë rrugës, të cilat historikisht kanë shërbyer jo vetëm për banorët e zonës por edhe për kalimtarët e rrugës nacionale.

Në veri të Komunës së Steblevës, mbi fshatin Zabzun shtrihet Mali i Zylit, mbi të cilin është ndërtuar një kështjellë që daton që nga koha e Skënderbeut, pra në periudhën e pushtimit otoman dhe quhet Kështjella e Cuccales. Në brendësi të kështjellës shtrihet qyteza, e cila është krejtësisht e pa eksploruar nga pikpamja arkeologjike dhe historike. Vetë lartësia në të cilën është ndërtuar kjo kështjellë rreth 1518 m mbi nivelin e detit tregon se ajo ka qenë një pikë strategjike dominuese nga ku mund të shikohet e gjithë komuna dhe Dibra e Madhe. Zbulimet në këtë kështjellë do të krijojnë mundësinë për të hedhur dritë mbi prejardhjen dhe mënyrën e jetesës së mbarë zonës. Në komunën e Steblevës ndodhen dhe pika të tjera referuese me interes nga pikpamja historike, kulturore dhe e traditës si: objekte të veçanta të fshatit Zabzun si xhamia që daton rreth viteve 1700, shkolla e vjetër, disa shtëpi karakteristike, kanionet e Liqenit të Draganit, Varret e Ogiçit, një gjurmë e një degëzimi të rruges "Egnatia", Shkëmbi i Kusarit, Varri i Marijes, Burimet e Stratorit, Vakëfi i Steblevës i cili ndodhet rreth 1 km nga ish posta e kufirit me Maqedoninë, e cila më parë ka qenë e hapur. Ky objekt kulti është shndërruar në pikë peligrinazhi për të gjithë vizitorët besimtarë për vlerat e rralla dhe vetitë kuruese për të cilat shquhet burimi i tij. Në zone ka disa objekte kulti të periudhave dhe stileve të ndryshme, gjë që dëshmon për një harmoni fetare në komunitetin e zonës.

Kushtet klimatike

Pozicioni gjeografik i kësaj zone bën që kushtet klimaterike të saj të ndikohen kryesisht nga masa ajrore që krijohen në brendësi të kontinentit, ndërkohë që efekti i detit nuk ndihet për arsye të distancës së madhe dhe barrierave malore që kufizojnë këtë zonë. Ndikimi i masave ajrore që vijnë nga brendësia e territorit është më i theksuar në fushën e temperaturave ku gjatë stinës së dimrit ato arrijnë vlera mjaft të ulta dhe rreshtet të dendura të dëborës.

Bujqesi, blegtori, pyje

Komuna e Steblevës ka edhe një sipërfaqe të konsiderueshme kullotash, livadhesh si dhe pyjesh komunale dhe shtetërore dhe konkretisht 10 000 ha pyje dhe kullota. Të gjitha këto i japin prioritet zonës për të zhvilluar bujqësinë e blegtorinë si dhe turizmin malor e veror për vetë hapsirën dhe kushtet që ka, si dhe në harmonizimin e të gjithë këtyre elementëve për zhvillimin e agroturizmit në këtë komunë.

Komuna e Steblevës ka kushte optimale për zhvillimin e bujqësisë pasi kjo zonë ka toka të përshtatshme për kultivimin e shumë kulturave kryesore, kryesisht patates.

Pemëtaria në këtë komunë është shumë e larmishme, por jo me shumë sipërfaqe të zgjeruar dhe peshën kryesore e zë molla, dardha, kumbulla, arra dhe qershia. Komuna shquhet për një larmi të madhe të bimëve mjekësore dhe aromatike, ku kryesoret mund të përmendim: dëllinjën e zezë, trandafilin e egër, murrizin, salepin, njëmijë fletëshin, balsamin, rrënjë sanzi, kamomili si dhe shumë e shumë bimë të tjera mjekësore duke qenë një nga zonat më të pasura me këto bimë dhe duke arritur një numër prej 80 bimësh, gjë që i rrit potencialin e zhvillimit të kësaj zone, ku mund të mendohet fare mirë jo vetëm për grumbullimin e tyre por edhe për magazinimin dhe përpunimin e tyre duke zhvilluar një politikë të qartë marketingu dhe punësimi gjithë vjetor të banorëve të zonës.

Në komunën e Steblevës mbarështrimi i blegtorisë është një nga burimet kryesore të të ardhurave familjare. Në këtë

komunë kryesisht mbarështrihen bagëti të imta. Komuna ka kushte shumë të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë, falë territorit shumë të gjërë të komunës dhe kryesisht të livadheve dhe kullotave të shumta, gjë e cila tregon potencialin e lartë të zhvillimit të këtij sektori dhe harmonizimin e tij me atë të bujqësisë dhe të turizmit. Numri i krerëve ka ndryshuar nga viti në vit dhe po ta krahasosh me numrin e familjeve që banojnë tani në komunë ai është rritur dhe ky numër do të shtohet dhe më shumë në të ardhmen për vetë kushtet e përshtatshme që ka kjo komunë për zhvillimin e blegtorisë. Komuna e Steblevës shquhet për sipërfaqen e madhe të pyjeve dhe të kullotave që arrijnë një sipërfaqe prej 9000 ha, një nga resurset më kryesore që e

bën këtë zonë të njohur dhe të kërkuar si nga vendasit ashtu edhe nga të huajt, një zonë mjaft të përshtatshme si për zhvillimin e turizmit malor, dimëror dhe veror.

Fauna

Larmia dhe pasuria që ka kjo zonë si në aspektin klimaterik, në atë të tokave, të florës, etj., ka krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e një bote shtazore shumë të pasur. Këtë gjë e dëshmon egzistenca e shumë specieve të veçanta, nga më të ultat dhe deri tek gjitarët më të zhvilluar të zonës, si dhelpira, cakalli, thëllëzat, shapkat, ujku, derri i eger, ariu, dhia e egër. Në habitatet e ujërave të kthjellta dhe shumë të ftohta të zalleve takohet trofta e egër, në zallin e Borovës dhe të fshatit Sebisht. Kjo e bën këtë zonë të dallueshme në të gjithë vendin për këtë pasuri të madhe ujore. Të gjitha speciet e sipërpërmendura së bashku përbëjnë një pasuri të madhe natyrore dhe vlera të mëdha stimuluese për të apasionuarit e gjahut, të natyrës, të apasionuarit pas jetës pastorale, etj.

Tregjet aktuale

Sic ndodh rëndom në Shqipëri, edhe në zonën e Steblevës ka të dhëna të kufizuara për turizmin, për numrin e vizitorëve apo për sjelljet e tyre. Komiteti i Veprimtari për Turizmin ndoqi një metodologji të caktuar për tu njohur me segmentet prioritare potenciale të tregut për rajonin e Steblevës.

Kjo u bë duke iu përgjigjur një sërë pyetjesh përkatëse në të gjithë segmentet e tregut që aktualisht vizitohen ose që mund të tërheqin turistë për të vizituar këtë rajon dhe më pas u bë një radhë bazuar në rëndësinë dhe potencialin që ato kanë. Mbeshtetur në analizën e bërë rezultoi se rreth 60% e vizitorëve vinin nga tregu i brendshëm. Ato janë ose vendas të larguar dhe me banim në qytete të tjera të Shqipërisë, ose vizitorë të apasionuar pas natyrës, sporteve, ushqimit dhe produkteve organike, gjuetarë etj. Pjesa tjetër e vizitorëve janë turistë shqiptarë, emigrantë që kthehen herë pas here në vendin e tyre, ose turistë të huaj të apasionuar pas natyrës, kampingut, jetës pastorale.

Kjo strategji përcaktonte vizionin dhe objektivat tona për zhvillimin e turizmit në Steblevë për 10 vitet e ardhshme deri në vitin 2021. Ky vizion mbështetet në parimet e cilësisë dhe qëndrueshmërisë. Përpjekjet për të përmirësuar dhe rritur ofertën turistike do të bëhen duke qenë në harmoni me mjedisin dhe duke synuar përmirimin e cilësisë së jetës për qytetarët e Steblevës.

Rikthimi në vendin e originës, në vendlindje

Tregu i "rikthimit të rrënjët e vjetra" i referohet atyre turistëve të cilët udhëtojnë

për të zbuluar trashëgiminë e tyre etnike dhe gjeografike. Aktualisht ato kthehen

për të vizituar të afërmit, për të marrë pjesë në evenimente të ndryshëm që organizohen, apo thjesht për të vizituar zonën e originës. Aktualisht ky përbën edhe tregun më të madh për momentin dhe do të vazhdojë të jetë një burim i rëndësishëm i vizitorëve në të ardhmen, prandaj është mirë të njihen nevojat dhe pritshmëritë e tyre. Ky është një treg i mirë edhe për të nxitur investimet në rajon.

Turizmi i fundjavës

Edhe ky shihet si një treg potencial për Steblevën edhe pse konkurrenca me rajonin e Korçës që ka krijuar brendinë e tij për këtë lloj turizmi në vend, do të jetë i lartë. Klasa e mesme që frekuenton fundjavën dhe vjen nga qytetet kryesore të Shqipërisë si Tirana, Shkodra, Durrësi, Fieri, Berati, janë të interesuar të zbulojnë sidomos kuzhinën dhe ushqimet locale dhe të marrin pjesë në aktivitetet natyrore dhe të aventurës. Me kalimin e kohës ky treg priret të jetë më i qëndrueshëm se tregu ndërkombehtar.

Gjuetarët

Ata janë turistë që u pëlqen të vizitohen vende të reja dhe ndërkohe të ushtrojnë edhe sportin e gjuetisë. Sigurisht zhvillimi i këtij tregu duhet të shkojë paralelisht me forcimin dhe zbatimin e ligjshëm mbi gjuetinë, me trajnimin e guidave specifike për këtë target grup dhe zhvillimin e shërbimeve mbështetëse. Ato mund të qëndrojnë më shumë se një ditë në rajon dhe për këtë arsye janë një grup që mund të sjellë të ardhura për biznesin vendas.

Përgatiti

**Mersin Hoxha  
KRYETAR I SHOQATES  
"STEBLEVA"**



Unë jam një prej nxënësve të kësaj shkolle të periudhës 1967-1974.

Mësimet e para banorët e këtij fshati filluan ti marrin jo zyrtarisht nga mësuesi Fasl Cami, banor i fshatit tonë, që në vitin 1940. Ai kishte mbaruar shkollën Normale të Elbasanit dhe ishte emruar mësues në shkollën e fshatit Gjoricë. Për shkak të vrasjes së tij nga një përlëshje me një patrullë italiane arsimimi i banorëve u ndërpre.

Fëmijët e fshatit tonë e zhvillonin mësimin në Gjoricë në një largësi rreth katër orë vajtje ardhje me këmbë.

Zyrtarisht shkolla në Viçisht u hap me 28 dhjetor 1944, një muaj pas çlirimit të Shqipërisë. Hapja e shkollës, sipas kujtimeve të mesuesit të parë nga Dibra e Madhe, Fehmi Kodra, u shoqërua me një festë të madhe të shoqëruar me të shtëna armësh.

Filloi mësimi vetëm në klasën e parë në të cilën u regjistruan 31 nxënës. Programi përfshinte lëndët: Abetare - Gjuhë, Arit'hmetikë, Vjersha, Punë kopshti, Mësim Jete, Gjimnastikë dhe Punë dore.

Një nga vështirësitë kryesore të asaj kohe, ishte mungesa e teksteve dhe e mjeteve mësimore. Kjo bënte që mësimi të zhvillohej në kushte jash-tëzakonisht të vështira.

Mësuesi banonte në familjen e Rrahman Xhekës dhe në muajt e parë mbahej vetëm nga kontributet e fshatarëve dhe të familjes ku banonte.

Në vitin 1945 ju caktua një rrogë mujore nga shteti. Ai punoi për dy vite shkollore 1944-1945

# 70 vjet Arsim në Viçisht

(1944 - 2014)

dhe 1945-1946. Në këtë vit mësues Fehmi transferohet në një shkollë tjetër dhe në vend të tij emrohet mësuesi Qeramudin Luka. Ai punoi deri në vitin shkollore 1950-1951.

Në vitin shkollore 1951-1952, rikthehet përsëri mësuesi Fehmi Kodra duke punuar tashmë me katër klasa kolektive. Numri i nxënësve është në rritje. Klasa e parë kishte 18 nxënës, klasa e dytë, 10 nxënës, klasa e tretë, 8 nxënës dhe klasa e



katërt 10 nxënës, në total 46 nxënës.

Shkolla fillore varej nga drejtoria e shkollës 8 vjeçare Gjoricë. Drejtore e shkollës ishte Bukurie Kaja.

Në vitin shkollore 1967-1968 u hap për herë të parë klasa e pestë dhe pas një viti u hap klasa e gjashtë. Në vitin shkollore 1968-1969 shkolla e Viçishtit kaloi me drejtori më vete. Drejtor i parë u emrua Emin Cami.

Hapja e shkollës 8 vjeçare krijoi mundësinë e regjistrimit edhe për shumë fëmijë të zonës së Gollobordës

Ish mësuesi i kësaj shkolle dhe mësuesi im i matematikës, z Latif Dema shkruan: "Në vitin 1973 u emërova në shkollën 8-vjeçare Viçisht. Nga ana profesionale më erdhi mire pasi prinderit e nxënësve të mi i njihja, por gjithashtu dija se fëmijët e fshatrave që përfshinte kjo shkollë ushqenin dashuri për dijen". Për rreth 20 vjet kjo shkollë funksionoi si shkollë 8 vjeçare. Për të vazhduar shkollën e mesme kishte tre mundësi: të merrje bursë shteti, të vazhdoje shkollën në Shupenzë ose tek ndonjë i afërm që banonte në qytet. Vazhdimi i shkollës së mesme në Shupenzë në kushtet e mungesës së transportit ju kushtonte nxënësve katër orë rrugë në këmbë njëloj si dikur nxënësit e shkollës 8 vjeçare shkonin në këmbë në Gjoricë. Në kujtimet e tij ish drejtori i kësaj shkolle Avni Mera shkruan: "Me mbështetjen e ministres së arsimit znj. Tefta Cami, në fshatrat Viçisht dhe Gjoricë në vitin 1985 nisi ndërtimi i shkollave të reja të cilat u inaguruan në vitin 1986.

Me kërkesën e banorëve të fshatit Viçisht dhe dëshirën e ministres së arsimit për të kontribuar në arsimimin e banorëve të fshatit Viçisht, ku ajo lindi

dhe u rrit si dhe zonës për rreth, në vitin shkollore 1986-1987 u hap arsimi i mesëm.

Bindja ime e hershme për banorët e fshatit Viçisht si njerëz të besës, punës, mikpritës dhe vullnetit për shkollim u provua kur hapi dyert arsimi i mesëm i përgjithshëm në këtë fshat të thellë por me shumë traditë. Nuk mund të harroj përpjekjet e vazhdueshme të njerëzve arsimdashës të këtij fshati për të mbështetur punën e mësuesve të kësaj shkolle dhe mua si drejtor shkolle -shkruan më tej ish drejtori Avni Mera".

Në shkollën e mesme u regjistruan 40 nxënës në vitin e parë. Në këtë shkollë u regjistruan edhe shumë nxënës nga Çereneci, Lubaleshi, Tërbaçi, Sepetova, Mireshi, Pasinka etj.

Pas vitit 1990 për shkak të lëvizjes së popullsisë drejt qendrave urbane si Peshkopi, Bulqize, Durrës, Tiranë etj u mbyll shkolla e mesme dhe ndërkohe bie shumë edhe numri i nxënësve të shkolles 9 vjeçare.

Në vitin shkollore 2004 - 2005 drejtorisë së shkollës Viçisht i bashkangjitet dhe shkolla e fshatit Lubalesh për shkak të rënies së numrit të nxënësve në këtë fshat.

Në vitin 2007 hapet për herë të parë shkolla fillore e Çerenecit të Epërm, shkollë e cila i kaloi edhe kjo në varësi shkolles së Viçishtit.

Në këto 70 vjet histori të



shkollës së fshatit Viçisht kanë punuar dhe kontribuar me qindra mësues. Shumë prej tyre kanë punuar jo vetëm në shkollën e Viçishtit por edhe në disa shkolla të zonës së Gollobordës si Pasinkë, Lladomericë, Tuçep, Ostren, Klenjë, Llangë etj. Disa drejtues shkolle në vite kanë qenë Emin Cami, Lirie Cami, Xhavit Sulku, Avni Mera, Dritan Ramizi, Fisnik Manjani, Rushit Suma, Femi Lika, Idriz Mera, Ajet Suma, Xhevrie Cami etj. Po kështu shumë ish nxënës të kësaj shkolle kanë vazhduar studimet e shkollës së mesme dhe studimet e larta. Disa prej tyre kanë marrë edhe grada shkencore.

**Dr. Shpëtim Cami**  
Kryetar i Njësis Bashkiake nr 1, Tiranë

## REPUBLIKA E SHQIPERISE SHOQATA STEBLEVA

Rr. Xhon Belushi, Vila 519 Qesarak, Tirane Tel:0695168173

### DREJTUAR

**Z. Bashkim Fino BASHKËKRYETAR I KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR REFORMËN TERRITORIALE**

**Z. Bledi Çuçi MINISTRI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET VENDORE**  
**Z. Arben Kamami PREFEKTI I QARKUT TË ELBASANIT**  
**Z. Taulant Balla DEPUTET I ZONËS**

### PROPOZIM

Shoqata "Stebleva" në mbledhjen e saj të datës 5 prill 2014, diskutoi për problemin e Reformës Administrative Territoriale.

Pas diskutimeve Ju propozojmë që Stebleva të jetë pjesë e Qarkut (Rajonit) Elbasan, Rrethit Librazhd.

Shoqata "Stebleva" është krijuar dhe punon si dhe është në aktivitet të plotë, për ruajtjen e traditave dhe zakoneve të komunitetit. Këto ne jemi në gjendje t'i ruajmë dhe t'i trashëgojmë sic kemi bërë deri më tani etninë tonë kulturore dhe kjo nuk ndikon për të bashkëjetuar me pjesën tjetër të komunitetit të Qarkut Elbasan, që nuk është dygjuhëfolës si ne.

Ne kemi arritur që me këmbëgjulje të madhe të ruajmë të pa prekur pyjet, kullotat dhe të gjithë faunën e Steblevës dhe dëshirojmë që këtë ta administrojmë dhe shfrytëzojmë në favor të komunitetit. Jemi pjesë e parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë ku 60% e tij është në territorin e Komunës Steblevë.

Jemi në një vijë për gjatë kufirit me Republikën e Maqedonisë dhe duam që resurset tona natyrore t'i shfrytëzojmë për turizëm veror dhe dimëror si të vecanta në këtë zonë.

Jemi plotësisht dakort që të bëhet bashkimi vullnetar midis Komunës Steblevë dhe Komunës Trebisht për arsye si më poshtë:

-Kemi qenë tradicionalisht në një lokalitet, kemi të njëjtat tradita ekonomike, historike dhe kulturore.

-Kemi dhënë dhe marrë (martuar) me njëri-tjetër prej shumë vitesh. Të dyja zonat flasin dy gjuhë.

-Ruajmë respekt ndaj njëri-tjetrit dhe të dyja besimet fetare Ortodokse dhe Myslymane bashkëjetojnë në mënyrë të shkelqyer.

-Prej vitesh problemet e gjendjes civile dhe të tjera i kemi zgjidhur në Librazhd dhe Elbasan, kemi qenë shumë të kënaqur, i kemi më afër si qendra. Edhe sot problemet e gjendjes civile janë në Librazhd dhe nuk kemi patur asnjë vështirësi.

-Në Steblevë cdo 6 Maj organizohet festa e luleve, e 6 majit, me një pjesëmarrje të gjithë komunitetit të zonës ku shpalosen gjithë traditat e zonës.

-Stabilimenti i Sharrave Steblevë ku ka qenë në aktivitet rreth 40 vjet dhe të punësuar mbi 1500 punonjës, të gjitha marrëdhëniet dhe veprimet i kanë patur me Elbasanin dhe Librazhdin dhe ka qenë një marrëdhënie e shkëlqyer dhe ruajmë respekt për rajonin Elbasan, Librazhd.

Për këto dhe shumë faktorë të tjerë ne jemi dakort që të bashkohemi me një komunë me emërtimin (Komuna Steblevë-Trebisht) Qarku, Rajoni Elbasan.

Kjo dakortësi u dha dhe u miratua nga të gjithë të pranishmit në takim in datës 5 prill 2014.

**Kryetari i Shoqatës "Stebleva"**  
**Mersin HOXHA**

## REPUBLIKA E SHQIPERISE SHOQATA STEBLEVA

Rr. Xhon Belushi, Vila 519, Qesarak Tirane Tel:0695168173

### DREJTUAR

**Kryetarit të Komunës Steblevë: z. Alban Fejza**  
**Kryetarit të Keshillit të Komunës: z. Fiqiri Gjini**

### KËRKESË

Lënda: Disa kërkesa të dala nga mbledhja e Shoqatës "Stebleva" me datë

22 dhjetor 2013, që nga ana juaj ti kushtohet vëmëndja e duhur.

1. Në territorin e fshatit Steblevë të mos bëhet asnjë veprim pa u konsultuar me përfaqësinë e Shoqatës, për problemet e fushës së investimeve nga jashtë komunitetit steblevas ose për cdo lloj veprimtarie tjetër.

2. Të mos ketë shfrytëzim apo menaxhim të pyjeve të paktën edhe për 2 vjet. I duam pyjet të paprekura sic i ka ruajtur vetë komuniteti nën drejtimin e shoqatës.

3. Të mos lejohet asnjë nga jashtë komunitetit të shfrytëzojë kullotat për blegtori e bletari.

4. Bimët mjeksore të të gjitha llojeve të grumbullohen vetëm nga banorët e fshatit.

5. Mbështesim plotësisht moratoriumin për ndalimin e gjuetisë.

6. Brenda ligjeve kërkojmë të zgjerohet vija e verdhë e fshatit, mbi rrugën nacionale.

7. Uji që na ka marrë Komuna Ostren t'i rikthehet zonës që i takon për nevojat e domosdoshme për tokat e Kutles. Në territorin ku është marrë uji është dëmtuar rëndë ekosistemi dhe nuk rrjedh asnjë pikë ujë, dhe nuk ka leje mjedisi e leje nga komuniteti.

8. Territori i Steblevës është ruajtur dhe do të ruhet sipas tapisë së trashëguar nga të paret tanë të datës 15.05.1937 dhe ne nuk lejojmë preken e saj.

9. Kërkojmë negociim të përbashkët për hapjen e pikës kufitare tek piramida 30 (fusha e Llakavicës)

10. Tokat në Steblevë të shfrytëzohen dhe të jepen me qera vetëm për steblevasit.

11. Të shkolla e fshatit të na jepet leje për ngritjen e një muzeu, duke na ndihmuar me ndonjë fond, si dhe hapjen e një zyre për shoqatën.

12. Kërkojmë vemendjen dhe negociimin e vazhdueshëm për asfaltimin e rrugës deri tek fusha e 30.

13. Të na merret mendimi dhe të konsultohemi për organizimin e ri territorial.

Lidhur me këto kërkesa presim përgjigje zyrtare nga ana juaj.

**KRYETARI I SHOQATËS "STEBLEVA"**  
**Mersin Hoxha**



# Stebleva djep i kulturës dhe patriotizmit masiv

Steblevas, gollobordas e të tjerë këtu në Tiranë kemi të preferuar si qendër "Bar-Kafen" e biznesmenit Abib Kormaku, ku mblihdemi përherë. Në këto ditët e fundit të muajit të "plakave" - siç i thotë populli, takoj të respektoar intelektualin Mersin Hoxha. Me dashamirësinë që e karakterizon më porositë të bëj një shkrim për numrin në vijim të gazetës "Stebleva" që ai drejton si botues i saj.

E pranova me kënaqësi. Që në fillim më duhet të them, jo për modesti, rashë në dilemë për çfarë të shkruaja, se Stebleva është një "Bjeshkë" e madhe me plot bëma, historia e ngjarjeve të brez para brezave e gjer në ditët tona.

Megjithatë sofra bujare e saj ka vend për të gjithë. Për të është folur e shkruar e do të shkruhet sërisht. Dilemë e dytë është se në këtë moshë që jam, në kapërcim të 79-tave, më jepet rasti të hedh në letër diçka, duke zgjuar vatrën e fjetura të kujtesës, për të thënë diçka të veçantë për një trevë me tradita të mrekullueshme në kohëra, të një heroizmi të pashoq të saj në rrjedhat e historisë. Pra, për Steblevën që i ka qëndruar në krye Gollobordës e fshatrave të saj, duke i vënë breroren e artë.

Të shkruash për Steblevën është sa kënaqësi aq edhe merak të përshfaqësh më të mirën, si: përpjekjet e pareshura të saj për dinjitet kombëtar, dashurinë e zjarrtë për vendlindjen e të parëve tanë, për zërin e saj vendimarrës, për t'i qëndruar ballë për ballë e me përkushtim momentin historik ndër vite e në vijimësi situatave e ngjarjeve të trazuar të kohës, duke u shquar për besëlidhje, trimëri e burrëri si në të kaluarën historike, ashtu edhe për cilësitë e veçanta si punëtorë e mjeshtër të talentuar, bujqë e blegtorë të palodhur, tregëtarë me zë jo vetëm në zonë, por edhe në Ballkan e me gjërë.

Stebleva me një territori të pamatë, të barabartë me territorin e rreth 12 fshatrave të Gollobordës e ka vendosur vetveten në hartën e Gollobordës e të Dibrës, shumë kohë më parë të ndarjes së sofrës në "Luftën e I Botërore", koha e ravijëzimit e formatimit të shteteve të Ballkanit e Europës. Dhe këtë realitet nuk ia fal kush, por e ka merituar. Le ti referohemi këtij episodi me një fakt sa domethënës aq edhe real, ndodhur aty rreth viteve 1850. "E shkurtër dhe e turbullt është jeta e atyre, që harrojnë të shkuarën, varrosin të tashmen, frikën prej të ardhmes..." - ka thënë filozofi, Seneka. "Dikur në malet e Jabllanicës erdhën vllahët me bagëti", - shkruan studiuesi, Prof. Milenko S. Filipoviq. Thuhet, - vazhdon ai, që të ardhurit morën leje nga Sulltani dhe u vendosën në malet midis Steblevës dhe Jabllanicës brenda sinorit të Steblevës. Steblevasit që jetonin në Llakaicë kullonin bagëtinë deri në afërsi të pyjeve, kurse në male ishin vetëm vllahët, të cilët malin e quanin pasuri të tyre.

Një ndër versionet e ikjes së vllahëve nga malet e Ste-

blevës e Jabllanicës është: Një herë kur çobenjtë ishin në Osoj dhe Prisoj e në Kuçovë disa hajdutë nga Dorza e Çermenikës marrin një dele. Çobanët njoftuan Qehajain, i cili u tha: "le ta marrin, për një dele mos të bëjmë sherr!". Kështu tha dhe kur morën delen e dytë: Por kur morën delen e tretë një nga qehahllarët, mori pushkën vetë dhe vrau një hajdut dhe urdhëroi të vetët që të përgatiteshin për të ikur. Sipas këtij version vllahët u larguan nga malet e Steblevës e Jabllanicës rreth viteve 1850, sepse në caringrad (Stamboll) humbën gjyqin për këto male.

E kështu, me të drejtën e fituesit, Stebleva ka sot këtë hapësirë, që në memorien e njerëzve ka mbetur shprehja proverbiale: "Ku ishte? Në çarjet e Steblevës". Ndërsa në sinor të Klenjës thuhet: "Në malin e Klenjës". Falë zemërgjerësisë e bujarisë steblevasit u thanë: "Malin po ua japim. Edhe ujin e keni marrë, prapë merreni". Kjo, sepse klenjasit nuk iu përgjigjën gjyqit të fituar vetëm nga Stebleva. Ajo nuk u mjaftua me kaq, por më vonë, në vitin 1913 u përkujdes dhe bëri Tapinë e parë. Dhe kështu vetëm Stebleva ndër 24 fshatrat e Gollobordës ka tapinë e territorit të saj.

Stebleva ka një sërë momentesh ku zëri i saj ka predominuar në vendimmarrje në saj të burrave trimë e të mençur të saj. Tipik është rasti i mosmarrveshjes me s Gjinovecit e Trebishtit për malin e Studeshnicës në "Beglicka livada" rrëzë Raducit, të Jagnička Krastës, malet e "Hamzoicës" e të "Xhanadollit". Stebleva është ngritur në këmbë sa herë janë bërë rovatje për të cënauar dinjitetin e banorëve të saj e të fshatrave të Gollobordës, sidomos të popullsisë autoktone të krishtere e myslimane. Tipik është rasti i kryebashibozukut Xhem Gostivari me bandën gjaksore të tij. Kërkesave ultimative nga ai e ngado që vinin për trazira, spastrime etnike, përcarje e lloj-lloj prapësirash të kaosit të kohës, Stebleva i është përgjigjur dhëmbë për dhëmbë, prerë e rreptë.

Trazirat e luftërave ballkanike, situata mjaft dramatike e kohës së Shpalljes së Pavarësisë më 1912 e të Luftës I Botërore, periudha e Neutralitetit, që prej 9 vitesh (1913-1922) ishin vite kur Golloborda u la në mëshirë të fatit, duke u bërë pre e lakmive grabitqare të shteteve fqinje e të Fuqive të Mëdha, që sollën pasoja të papërshtueshme të rrënimit e shkatërrimit, djegies së fshatrave të Gollobordës në vitet 1913, 1915 e 1920. Megjithatë spikati në shkallën më të lartë heroizmi masiv i banorëve në mbrojtje të trojeve të veta. Mbështetja e përkrahja ndërkrahinore qe unikale në llojin e vetë. Rezistenca antisërbe kulmoi në betejën e Shkallës së Përvallit e të betejës së Steblevës në 1920, ku heroizmi i pashoq e masiv i burrave dhe grave trmëresha me Steblevën në krye solli fitoren. Kjo fitore me asgjësimin e mbi 300 të vrarëve u kushtoi shtrenjtë forcave pushtuese, saqë habiti dhe drejtues e ush-

tarakë të lartë të tyre, ku një gjeneral u shpreh: "Hallall, ludi rodeni za vatan!" (Hallall, njerëz të lindur për vatan!)

Shekullit të kaluar Stebleva dhe tërë Golloborda nuk i ka mbetur borxh, sepse kjo zonë me dell patriotik, me përfaqësuesit e saj të gjithpranishëm ka qenë kontribuese e spikatur si në Shpalljen e Pavarësisë më 28 nëntor 1912, gjatë Luftës së I Botërore, në çeljen e sh-



kollës së parë shqipe, (më 14-15 Prill 1914) përkatësisht në Peshkopi e në Trebisht. Këtyre 100-vjetorëve historike u bashkëngjitet edhe 100-vjetori i tapisë së parë, që e ka vetëm Stebleva edhe sot si dokument themeltar për territorin e saj.

## Stebleva mbartëse e traditave më të mira

Në kufinj të këtij shkrimi, shkurtazi do të cekim edhe ndonjë fragment nga galeria e pafund e traditave më të mira të Steblevës, që shprehin një kulturë të admirueshme, për ta patur zili, që u transmetohet brezave të rinj. Stebleva shquhet për një solidaritet ndërkrahinor e vëllazëror. Ajo dallohet edhe për një shkallë të lartë emancipimi shoqëror. Ajo në këtë linjë shfaq një model të përkryer të shpirtit njerëzor e vëllazëror, larg çdo paragjykimi a mentaliteti të sëmurë arkaik si të fanatizmit ekstrem, të përbuzjes a zilisë, të indiferentizmit, të patriarkalizmit, servilizmit, a të qenit për bujë e nam. Le të marrim një rast mjaft kuptimplotë, pa u futur në thellësinë dhe gjerësinë e gjërave. Në Steblevë, ndryshe nga fshatrat e tjerë, psh, në dasma po të futesh në valle mikse vargu nuk "këputet", madje vallja vazhdon më hareshëm nën tingujt e ëmbël të cyrrleve e lodrave. Në fshatrat e tjerë ndodh pak më ndryshe, në valle kapen kryesisht veç njerëzit shumë të afërt të të zotit të dasmës.

Bujaria, mirësjellja e çiltërsia, mikpritja të lënë mbresa të pashlyeshme. Duke punuar për më se 20 vite si kryeredaktor i gazetës "Ushtima e maleve" e ndjeja rrallë herë tek bisedohej në oda dibrane a mjedise, se gjoja mikpritja në Gollobordë qenka më e zbehtë se në zona të tjera të Dibrës, gjë që nuk përputhej me realitetin konkret. Ndaj sjell në kujtesë një episode. Për punë të gazetës vinin nga Fushë-Studna për në Sharrë të Steblevës bashkë me redaktorin e gazetës sonë Fadil Meha dhe shoferin simpatik Baftjar Zeneli. Sapo kaluam te shtëpitë e Ismail Llapës e të vëllezërve të tij, në të majtë të rrugës automobilistike në një shesh (livadh) kërciste lodra, bëhej dasmë. Oficeri ushtarak Mitat Shabani martonte vëllain

e tij. Sa u afroam në anë të xhadesë i them shoferit: "Ndal! Këtu do të zbresim e do të pimë një kafe, jo se jam steblevas, por dhe i mirpëritur e mirënjohur në zonë. Vallja e ahengu vazhdonin me intesitet edhe më të lartë në tingujt e orkestrës kaq tërheqës, sa më gufante zemra nga gëzimi. Në çast të zotët e dasmës u renditën duke na prirë brenda në konak për të pirë kafën e rastit. Në përcjellje pa u ndarë i them Mitatit: "Do të futem në balle. - Me gjithë qejf, mor mik!" Ndërkohë u bëj me shenjë shokëve që edhe ata të hynin në valle. E ç'të shohësh, rrathët koncertrikë pushtuan gjithë sheshin. U kënaqëm aq shumë, sa shokët mbetën të bëfasuar nga ky ceremonial si ansambël artistik. Sipas zakonit të zotët e dasmës e të njohurit e mi na përcollën gjer në xhade me gjithë orkestër. Në udhëtimin tonë drejt Peshkopisë u them shokëve: "-E, e shihni, kjo është Stebleva ime! Ne çfarë na mbetet? Ta pasqyrojmë në gazetë."

\* \*

Ishte pranvera e vitit 1981, kohë kur plasën demonstratat masive në Kosovë. Po bisedonim me shokët redaktorë se çfarë mund të bënim për të nxjerrë më në pah heroizmin e popullit dibran në luftat për liri e pavarësi. Ndër zonat më të nxheta, shesh betejash me pushtues të ndryshëm të fillim shekullit të kaluar, ishte Stebleva me rrethinat e saj. Ndaj me redaktorin e gazetës sonë, Kamber Farrukun morëm rrugën drejt Steblevës. Kjo zonë është pëllëmbë e hsiatori qëndrese kundër lakmive të pangopura të shteteve fqinje, serbo-sllave. Duke rrahur mjaft mendime me punonjës të Sharrës, aty nga buzëmbremja zbritëm në fshat. U drejtuar tek shtëpia e Vesel Abazit, punonjës në administratën e Sharrës Steblevë. Me thirrjen time: "O i zoti i shtëpisë, a doni miq?" U shfaq sa hap e mbyll sytë, ai Vesel i buzëqeshur plot nur e hijeshburri na ftoi: "Bujrum o Velo, mirëse na erdhët!" Na priti me shumë bujari. Veseli njohës i traditave, zakoneve, dokeve dhe bëmave të hsiatorisë së zonës. Atë natë muhabeti s'kishte të sosur. Na fliste me aq kompetencë si historian sa ne habiteshim me dijet e tij, duke përhumbur në orët që xhironin përtej mesnatës. Bujtëm aq mirë, me ngrohtësinë e një mipritjeje gati dehëse, sepse ne morëm siç deshëm një material me shumë vlerë, me të cilin gazetari ynë qëndisi një artikull të mrekullueshëm, që e botuam në gazetën "ush-tima e maleve".

\* \*

Për nevojat e gazetës ne shkollim në zona edhe për të instruktuar rrjetin e bashkëpunëtorëve dhe të korrespondetëve vullnetarë të gazetës, por edhe për të parë si i thonë fjalës, me sytë tanë. Duke takuar dhe biseduar me njerëz të thjeshtë e kuadro njiheshim me gjendjen e punët në terren. Me redaktorin Abdurrahim Ashiku dolëm në brigadat e punës, në Orvenik, në rrethinat rreth

Sharrës, rrëzë kodrave të malit Tamiz, në lagjen Disha e të Projkajve. Ishte vjeshta e vitit 1985. Takojmë brigadierin e dalluar, Hatixhe Avda. Ajo, për meritat e punës ishte zgjedhur deputete e zonës së Gollobordës. Sa na pa thirri me zë:

- Po ku je mor Velo, se na keni harruar!

- Ja ku erdhëm Hatixhe, - i them.

Në bisedë na informoi gjërë e gjatë për ecurinë e punëve të ekonomisë së Steblevës, e shquar në atë kohë në shkallë rrethi për rendimente të larta, sidomos në prodhimin e patates. Kujtojmë se në ato vite ekonomia e bashkuar e Steblevës ka prodhuar rreth 5000 tonë patate. Në largim na tha: "Sonte s'keni për të ikur, ju pres në fshat për darke". Kësaj ftese të sigurtë me kënaqësi iu përgjigjëm. Sa u futëm brenda në shtëpi, ku na priti bashkëshorti i Hatixhes, Mustafai, një djalë simpatik dhe elegant, kur shohim në konak, gjetëm edhe zëvendëskryetarin e Komitetit Ekzekutiv të rrethit Musa Rama dhe kryetarin e Lokalitetit Klenje Ahmet Pirushi. Kjo qe një "valle" jo e vogël. U ulëm ca rreth orxhakut, ca në një minder të rehatshëm si në bedenat e kalasë së Gjirokastrës. Sa filluam bisedat përshëndetëse, kur në një mënyrë të beftë hyri në konak xha Ibrahim Avda, sa kishte zbritur nga qyteza e Sharrës dhe kishte rrokullisur gjysëm shishe konjak. U ul në një anë të oxhakut, plot humor dhe udhëhoqi atë natë ahengun me lloj-lloj barcaletash.. ia filluam mbarë e prapë muhabetit e dialogut, duke folur pa rradhë nën avujt e rakisë, me shëndete dashamirëse me njëri - tjetrin. Unë dhe Ahmeti (që s'para i pëlqenin kësi shakash e njihnin aq mirë xha Ibrahimin (vje-hrrin e Hatixhes), por po habiteshin dy shokët e tjerë Abdurrahim Ashiku dhe Musa Rama nga këto shfaqje humorit dhe nxitje për të avancuar në pije - Brumb me shishe e tokte me ne xha Ibrahim. Për çudi mbas çdo pauze pëshpërishte një shprehje krejt të panjohur për ne: "Byrazer or byrazer, pash perëndinë, mos je ti që më hangre dhinë dhe më le çjapin?" Dhe shtonte një shprehje tjetër disi më të kriprur të shoqëruar me pasthirmën: - Ah, që na u vjetëruan rimorkjot...! Kaq shpesh i pëshpërishte këto shprehje, si refren, sa që ne sot e kësaj dite i kemi fiskuar në kujtesë.

Pritje kaq gazmore, kaq bujare edhe si estradë nuk e improvizon dot. E ç'ti bësh komente? Vetëkuptohet. Në Steblevë kudo të futesh krahehapur të presin. Mikpritja shkëlqen si drita e diellit në qershor-korrik te këta njerëz humanë e tepër paqësorë. Tani për tani po e le me kaq.

Në mbyllje të këtij shkrimi më duhet të pohoj se: - Steblevën sa më shumë ta lëvrosh aq më shumë ta xhevahire do të nxjerrësh për t'ia lënë si pasuri shpirtërore brezave të rinj.

E, kështu me plot gojë them: "Me kohë në shumë tregues Stebleva e ka kapur trenin Europian të BE-së."

**Velo Cfaruku**  
shkrimtar-publicist



# Golloborda dhe Trebishti në 100 vjetorin e shkollës shqipe

Në historinë e përpjekjeve dhe të sakrificave për identitet kombëtar, Golloborda, si pjesë e Dibrës, ka dhënë kontributin e vet që e bën krenare në këtë 100 vjetor të gjuhës shqipe në Trebisht.

Ky kontribut fillon që në kohën e Skënderbeut, kulmon me shpalljen e Pavarësisë e në vecanti për mbrojtjen e tërësisë territoriale prej djegieve e masakrave serbe në vitet 1912-1922, vazhdon me rezistencën aktive ndaj pushtuesit nazifashist duke e shkruar kështu historinë e vet me gjak e duke qenë krenare në mbijetesën e saj me dinjitet edhe në ditët tona.

Qëndresa historike e Gollobordës ka patur si gjithmonë për simbol flamurin dhe flamurtarë për gjuhën e kulturën shqipe u bënë patriotët Hoxhë Hasan Moglica, Hoxhë Hazis Lila, Dan Cami, Elez Koci, Vasil Pleushku.

Figura e Hasan Sheremetit-Hoxhë Moglicës është një mdalion më vehte në gjerdanin e artë të historisë së Gollobordës e më gjërë. Shtëpia e tij ka qenë vatër e atdhetarizmit. Gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ka strehuar për dy netë Abdyl Frashërin. Në vitin 1902 bëhet vatër e mësimit dhe e shkrimit të gjuhës shqipe, mësues në Dibër të Madhe e pjesmarrës në Kongresin e Elbasanit në shtator të vitit 1909. Me 28 Nëntor 1912 ngre flamurin në catinë e shtëpisë së tij në Okshutun.

Në Vicsht qendër e luftimeve antiserbe dhe antibullgare ishte Dan Cami. "Hej Dan Cami mor ku je, Lulja e Shqipës për Atdehe." Patrioti e intelektual me përmasa kombëtare, Hazis Lila nga Stebleva ishte delegat me votë këshillimore i Gollobordës dhe i Berzheshit në Kongresin e Manastirit për alfabetin shqip, pjesëmarrës në ditën e Flamurit në Vlorë dhe me tu kthyer e ngriti flamurin në Klenje si kryetar i krahinarisë. Në Steblevë flamurin e ngre në kullat e veta intelektuali e studiuesi Vahit Kormaku. Në Ostren të Madh patrioti i pushkës, Elez Koci e ngre flamurin në ballkonin e shtëpisë së vet. Disa ditë më vonë një grup specialistësh nga Trebishti nisen nga Vlorë, me në krye Ali Terziun që mban të fshehur në gjoks flamurin, kalojnë në rrugëtimin Tiranë-Priskë-Bizë-Borovë përmes kontrolleve të panumërta serbë dhe me të mbrritur në Trebisht e ngrejnë në minarenë e xhamisë Bala. Kësaj periudhe i takojnë vargjet e poetit Zeqir Hysa: "Golloborda mal e gurë/Bukur po qëndis flamur."

Si gjithë Dibra edhe Golloborda gjatë pushtimit e copimit të tokave shqiptare prej serbve gjatë viteve 1912-1922 u bë shkumb e hi dhe dëshmi e masakrave që historia nuk i harron lehtë.

Në udhëtimin e tyre në Gollobordë, misionari amerikan në Korçë, Kenedi dhe dy përfaqësues të legatës bullgare i paraqesin me rënqethje ato, në

gazetën "Përlindja shqiptare" nr.4 dt.11 janar 1914. Këto masakra filluan në dhjetor 1913 e kulmuan në pranverën e vitit 1915 me Qafën e Prevallit ku u pushkatuan 500 burra,gra e fëmije dhe mes tyre edhe patrioti Hoxhë Hasan Moglica. Ja si shprehet Hoxha para pushkatimit:

"Ju vërtet na keni pushtue/ Ne një

Artemisa Haxholli, Qamil Kopani, Emili Bulgareci, Persefoni Saharia, Pavlina Prendushi etj. Ky kontribut gjithë përfshirës i jep këtij eventit përmasa kombëtare.

Shkolla e Trebishtit u bë frymëzuesja e hapjes së shkollave të tjera në zonën e Gollobordës. Më 1922 hapet në Ostren të Madh, me mësues Hamdi Muca, me 1923 në Borovë

medin Zajmit "Piktor i Popullit" dhe Heronjtë e Punës si: Kamber Shevroja, Mehmet Bekteshi, Hasan Bekteshi, Jonuz Muca, Mllan Drushku, Ramazan Seferi e Trajce Mazniku.

Masivizimi e forcimi i arsimit në Gollobordë arriti në vitet '70-'80. Arsimi 8-vjecar u shtri në të gjitha fshatrat.

Në Steblevë shkolla bëhet drejtori më vehte në vitin 1969.

Ahmet Tola, Lefter Cfaruku, Kostadina Drushku e Andrea Drushku. Në vitin 1986 hapet gjimnazi. Shkolla numëronte mbi 500 nxënës e një staf pedagogjik me 50 mësues, gati të gjithë nga fshati e me arsim përkatës.

Mirënjohje atij brezi të përkushtuar si:Dobe Nina, Angje Nina, Mark Marku, Ajat Sadiku, Hasan Shahnaj, Nazif Hoxha, Ilo Marku, Bardhyl Manjani, Razi Rama, Hyqmet Piraj, Emision Gjini, Veladin Tafaj, Lumturie Cadri, Nazije Tafaj, Lirie Veliu, Xhezmië Oruci, Mustafa Sinani, Elife Cenaj, Milica Cfaruku, Remzije Jella, Zhaneta Qirici, Adem Abdij, Shpetim Tafaj, Vera Terziu, Lirim Zepaj, Nexhat Basha, Fadil Allaj.

Mirënjohje u takon drejtuesve të kësaj shkolle në vite si:Selim Alliu, Mustafa Shahinaj, Mehmet Cadri, Fidan Marku, Ramazan Cadri, Halil Hoxha, Flutura Shahinaj, Mentor Cadri, Ibrahim Alla, Kadri Ajazi, Nazif Hoxha, Ardian Seferi. Sot shkolla ka 150 nxënës e 38 fëmijë në kopsht, ku japin mësim mësuesit: Luan Sadiku, Ramazan Ajazi, Rasim Sadiku, Rozeta Hoxha, Eglantina Sadiku, Flutura Balla, Ermal Fetahu, Mlena Zhivina, Endri Ajazi, Fehmi Rapa, Fatos Forgali, Kimete Osmani, Dallandyshe Emiri.

Golloborda, historinë e saj dhe kontributin për identitet kombëtar, për gjuhën e kulturën shqipe, e ka shkruar me gjak e me djersë. Nuk ka krahinë që të jetë gjakosur kaq shumë e të ruajë të shenjtë flamurin kombëtar, që për 100 vjet valëvitet në cdo dasëm edhe në ditët tona në fshatrat Trebisht, Steblevë, Ostren i Madh e i Vogël. Ja si këndohet për flamurin në dasmat e Gollobordës:

*Orosa rosit vo Arbanoshka zemja*

*Vesa veson ne token arberore Shto ni na rosi cervenion bajrak Sec e vesoi flamurin e kuq Shto ni na rosi kitani sfatoi Sec i vesoi krushqit e stolisur.."*

Ky është një himn i vërtetë i Gollobordës, një krahinë e qetë në punë, në hallet e në gëzimet e veta, arsimdashëse, punëtore e mikpritese, pa hasmëri e larg kronikave të zeza. Në këto 100 vjet dyert e shkollës së Trebishtit i kanë mbaruar me mijëra nxënës e janë me qindra intelektualë të shquar në fusha të ndryshme të kulturës, shkencës e ekonomisë, me potenciale intelektuale të përmasave kombëtare.

Brezat përulen me veneracion para këtij Obelisku të ABC-së në Trebisht e më gjërë.

Edhe kur thinjat do të na mbulojnë kryet,

Ndërmend do sjellim një emër nderues,

Emrin e thjeshtë, por të madh, Mësues!

**Mehmet Hasani**

*(ish nxënës i kësaj shkolle dhe drejtues në shkollat Studen e Klenjë për gati 15 vjet)*



ditë kemi me fitue/

Në këtë vend ku unë po bi/ Ka qenë e do jetë Shqipni"

Me 7 qershor të vitit 1915 në fushë të Llakaicës, në pabesi vritet patrioti Hazis Lila, hoxhë dhe mësues i shquar, kurse me 4 mars 1916 forcat serbe rrethojnë Ostrenin e Madh, arrestojnë patriotin Elez Koci së bashku me Qazim Dukën dhe pasi i masakrojnë, i varrosin të gjallë. Gjatë kësaj periudhe Stebleva digjet tre herë, me 1913, 1916 dhe 1920.

Në këtë valë terrori, patriotët e mëdhenj si Josif Bageri, Sait Najdeni, Hazis Lila, Hoxhë Moglica, etj vendosën në zbatim të vendimeve të Qeverisë së Vlorës e më pas të Princ Vidit hapjen e shkollave shqipe me 14 prill 1914 në Peshkopi, me mësues Haki Sharofi e me 15 prill 1914 në Trebisht, një fshat i madh me 500 shtëpi, me mësues Ramiz Qatja, të dy nga Dibra e Madhe. Patriotët, në themelet e këtyre fidanishteve, vunë thesarin më të cmuar: kulturën e tyre atdhetare, librat e shkronjat shqipe duke i mbrojtur me armë, ndërsa populli i Trebishtit hapi shtëpinë më të mirë në fillim në Celebi e më pas në kullën e Idris Muës, në qendër. Ndërsa në vitin 1948, me kontribut vullnetar e ndërtoi shkollën e cila ruhet në kujtesën tone me nostalgji. Që në ditët e para u regjistruan 20 fëmijë si:Ramadan Destani, Mehmet Cereni, Ajdin Dyrmishi, Mustafa Cela, Mehmet Selimaj etj.

Nga lartësia e këtyre 100 viteve ne përulemi me mirënjohje para qindra mësuesve që shërbyen në Trebisht që nga Vlorë, Fieri, Kavaja, Elbasani, Korça,Shkodra e Dibra si :Ramadan Sefedini, Nazmie Pasholli, Imer Gjata, Qamil Skuqi,

dhe1925 në Steblevë, me mësues Vahid Kormakun, me 1926 në Klenjë, me mësues Hasan Ahmeti e më pas Ali Narazani, me 1929 në Gjinovë me mësues Kamber Osmani. Mësuesit e parë normalistë si Selim Alliu, Mehmet Cadri, Mustafa Shahinaj, Islam Hoxha, Hilmi Sadiku e Gafur Ibrahim i u bënë metodistët e drejtuesit që frymëzuan plejada të tëra mësuesish më vonë.

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalclirimtare populli i Trebishtit mobilizoi 200 partizanë në Brigadat IV e XVIII dhe i dha luftes 10 dëshmorë si :Bajram Kasa, Hasan Koci, Arif Haxhiaja, Muharem Sinani, Mehmet Ajazi, Memish Shevro, Njazi Seferi, Rahman Haxhij, Shaqir Pupuleku e Zenun Abdij.

Në vitin 1953 hapet shkolla 7-vjecare në Trebisht e në vitet '60 një brez i tërë mësuesish vunë bazat e arsimit e të edukimit në shkollë si: Arif Ajazi, Sefedin Hasani, Zylfi Hasani, Ismail Sinani, Josif Koja, Ferit Ademi, Menduh Haxhij, Hamit Oruci, Hysen Koci,Eqrem Sinani, Elmaz Ibrahim, Karaman Tola, Sahit Kanxha, Raim Limani etj

Mirënjohje mësuesve të mi në vitet 1959-1965 dhe të brezave si:Agim Shahinaj, Rabije Cela, Xhevahir Cadri, Mustafa Shahjinaj, Mehmet Cadri, Velo Cfaruku, Emri Dedja, Muharem Kurti, Myrteza Mera, Sami Rec, Shuaip Skara e Aleksander Budini. Gjatë muajit janar të vitit 1969 kam zhvilluar praktikën pedagogjike në ciklin e ulët në Bala me mësuese Dashurie Daci. Mirënjohje mësuesve të kësaj shkolle si Hike Strazimiri, Branko Popaj, Osman Sinani, Hilmi Oruci.

Në historikun e shkollës është e spikatur figura e Nexh-

Mësuesit e parë që shërbyen ishin: Vahit Kormaku, Islam Hoxha, Gani Kormaku, Izet Gruja, Xhevahir Gruja. Të parat femra që dolën mësuese ishin: Fanije Hoxha (Reka), Sabrije Pirushi, Teuta Kormaku. Deri në vitin 2004 shërbyen mbi 50 mësues me drejtues shkolle: Ferit Uliu, Selman Purde, Iljaz Bande, Rexhep Despoti, Halil Kurti. Nga Stebleva janë mbi 70 mësues që kanë shërbyer brenda e jashtë në qytetet të tjera të vendit. Një në tre shtëpi i bie të jetë mësues. Figura me reputacion si:Qazm Gjini, Osman Uliu, Cfatani Zorba, Vesel Kucuku, Ramazan Hoxha, Fatmira Pirushi, Aishe Hoxha, Shpetim e Bardhyl Kormaku, Perparim Pirushi, Hajrie Kormaku, Artan Lila etj.

Në Borovë drejtues vihat Namira Cani e vazhdojnë shkollën mbi 190 nxënës.

Në Studen hapet shkolla 8vjecare duke terhequr nxënës nga Llanga, Zabzuni e Prodani me drejtues shkolle: Qerime Avda, Muhamet Sula, Mehmet Hasani, Rexhep Despoti, Vebi Doci, Pëllumb Gjini.

Hapet shkolla 8-vjecare në Sebisht me drejtues shkolle: Rexhep Cela, Muhamet Karaxha.

Hapen shkollat e mesme bujqësore në Klenje në vitin 1976 e më pas gjimnazi në vitin 1984. Mirënjohje drejtuesve në shkollën e mesme të bashkuar "Spiro Velko" : Islam Hoxha, Velo Cfaruku, Aleksander Budini, Mitre Shutku, Mehmet Hasani, Halil Kurti, Abdulla Seferi.

Hapen shkollat e mesme bujqësore në Tuçep, Ostren i Madh, Okshut dhe Vicsht. Në Trebisht hapet shkolla e mesme bujqësore me shkëputje nga puna, ku dhanë mësim specialistët si: Shahin Hasani,



# Sali Mustafa Hoxha

Saliu është lindur me 11 janar 1932 në Stebleve. Që në moshën 11 vjeçare pa mbaruar klasën e katertë i rra barra e rende të mbante familjen, mbasi baba i tij, Mustafai me 1944 u vra gabimisht nga partizanet e Brigades I Sulmuese ku kishte dale për ti pritur bashkë me dy bashkëfshataret e vet. Meqenese dyqani i tij në Korçë kishte qene baze e Luftes sepse kishte mbajtur me ushqime partizanet, baba i tij në atë kohë u konsiderua viktime e luftes.

Në Korçë Saliu punoi në dyqanin e te jatit për rreth tre vjet. Me të ardhurat që siguronte nga dyqani mbante gjithë familjen në Stebleve. Aty punoi deri sa pushteti i asaj kohe sekuestroi dhe mori dyqanet. Rreth vitit 1947 kthehet në Stebleve, ku punoi për 4 vjet si shites në dyqanin e fshatit dhe 2 vjet në Tiranë ku shquhej për ndihmen që ju jepte fshatareve të vet. Saliu nuk kthente asnjë njeri që nuk kishte mundësi për të paguar, por e ndihmonte me cdo formë.

Në vitin 1955 mbasi beri një kualifikim me rezultate të shkëlqyera në një kurs të pershpejtuar për ekonomist caktohet në stabilimentin e Sharrave të Stebleves si shef plani dhe kuadri, ku punoi për rreth 30-35 vjet. Në këtë funksion ku kryente dhe detyren e zëvendës drejtorit ai shquhej për aftësi profesionale, korrektesë dhe për rregullsi pune të



admirueshme. Në aktivitetin e tij të punës disa vjeçare ai ka gezuar një respekt të madh nga të gjithë punonjësit e ndermarjes, sepse ishte i pergjegjshëm dhe shumë komunikues me punonjësit. Mendohej me gjithë mundësitë e tij të zgjidhte në kohë të gjithë hallet dhe shqetësimet që kishin punonjësit. Ndihmonte vecanerisht njerzit në nevojë për ras-

te gezimesh dhe hidherimesh, me paradhanie, me ushqime etj. Ndihmonte edhe nxenesit e shkollës që në sezon pushimesh të punonin dhe të siguronin të ardhura për të paguar librat dhe rrobat e shkollës.

Shifrat e planit real dhe perspektiv që jepte ai ishin të sakta, pa gabime dhe realizimi i planit dilte ashtu sic e parashikonte. Aqif Mysliu, drej-

tor i stabilimentit në atë kohë thoshte: "Planet dhe realizimet e tyre i di Salcja", sic e thirrnin dhe shoket e tij. Punën në zyrë e gershetonte shumë mire me punën në teren për të verifikuar shifrat dhe realizimet. Nuk e ndalonte as bora dhe as furtuna për të shkuar në cdo sektor qoftë dhe me veshituri, aty ku punohej dhe realizohej plani.

Nga shoket e administratës dhe puntoret e stabilimentit gezonte një respekt të madh. Ishte model i disiplinës në punë shkollës i pari në punë e kthehej i fundit. Kujdesej me merak të madh që secilit puntor ti jepte haku që i takonte si për sistemin në punë dhe për rregullimin e dokumentacionit për pension kur i vinte koha.

Saliu ishte mjeshter i vllës dyshë tradicionale dibrane. Nuk kishte dasem në Stebleve ku të mos shpalojë mjeshteria e ketij valltari virtuoz dhe kolegut të tij Sami Kurti. Prandaj edhe u kerkuan nga Instituti i Folklorit në Tiranë për të marrë pjesë në veprimtari kombëtare dhe nderkombëtare.

Saliu rriti dhe edukoi gjashtë fëmijë, pesë cuna dhe një vajzë, arriti të arsimoj dhe ti sitemoj që të gjithë. Vdiq me 24 mars 2001, i nderuar nga të gjithë bashkëfshataret dhe miqtë e tij.

Ing. Enver Koçi, Librazhd

## LËVIZJA DEMOGRAFIKE, EKONOMIKE DHE TRADICIONALE E FSHATIT STEBLEVË NDËR VITE

Nga Ferit BUSHATI

Stebleva, ky fshat i territoreve të gjëra, plot pyje, bjeshkë dhe burime, plot shpate, lugina dhe livadhe me bimë medicinale qysh para Luftës së I Botërore ka qenë kultivues i thekrës dhe i grurit. Hangarët e drithit nën Osoj, vathët e vllhëve në Llakaicë tregonin për këtë fshat prodhimtar në anë të bjeshkëve që përveç bagëtive kishte edhe të mbjella të bollshme që shtriheshin deri në Sohodoll, Vetarnik e deri në Gumnisht.


Kujtoj kur pleqtë e lagjes Emro Feta, Sherif Avda, Hajrulla Avdiu, Veli Bushati dhe Qerim Shabani ulur nën strehët e shtëpisë përballë diellit bisedonin shtruar me njëri tjetrin për Steblevën e para Luftës së I Botërore që aso kohë numëronte mbi 350 shtëpi, të gjitha me dy kate. Në katin e parë strehonin bagëtitë, ndërsa në katin e dytë banonin vetë. Shtëpi prej guri, me mbulesa druri e me oxhaqe. Buka piquej në cerepe prej balte argjili. Fshatarët mbijetonin kryesisht me bagëti. Ata kishin mbi 15 mijë kokë bagëti të imta dhe cdo shtëpi kishte edhe nga një kallë dhe nga një lopë për qumësht e për mbarë.

Në dimër i shtëpëtonin bagëtitë në Selanik. Më kujtohet që Jakup Agushi fliste për xhaxhanë e tij Jonuzin që e kishin vrrarë në Solluncka Pole duke kullotur bagëtitë, ndërsa vëllai i tij Emiri e kërkoi me vite.

Në vitet e pas luftës së I Botërore fshati u dogj tre herë, varfëria dhe zia e bukës dominonte, njerëzit vdisnin për bukë. Në këto kushte shumë familje kanë emigruar në Turqi, Bullgari dhe Maqedoni. Gjithashtu kanë imigruar brenda vendit në Labinot, Librazhd e ku të mundeshin. Kur ktheheshin i gjenin shtëpitë të djegur dhe detyroheshin që tja fillonin nga e para.

Kështu rreth viteve 20 të shekullit XX, Stebleva u zvogëlua në 140 ekonomi me 700-800 frymë në kushte ekonomike shumë të vështira.

Gjatë regjimit të Zogut kishte rregull e qetësi dhe ekonomia filloi të përmirësohej. Ligji dhe drejtësi dominonte. Lëvizja e lirë ishte e plotë. Dokumentacioni ishte model. Tapitë dhe regjistri-



mi i pronave edhe sot janë për tu marrë shembull. Vetëm gjatë Luftës së II Botërore pati djegje dhe humbje dokumentacioni. Dokumentacioni i zonës sonë në vitin 1945 ndodhej në Zerqan dhe është djegur. Më pas regjistrat u bënë nga e para. Pas vitit 1950 filluan lëvizjet e para jashtë Steblevës sepse pati kërkesa për fuqi punëtore. Bile në ndonjë rast ka patur edhe detyrime për tu larguar sepse kishte nga ata që nuk dëshironin të largoheshin nga fshati. Buka dhe drithi nuk sigurohej në fshat as për disa muaj. Drithi blehej në pazarin e Shupenzës dhe të Elbasanit. Një

kv drithë kushtonte sa një rrogë mujore dhe nuk e blije dot. Pas viteve 50 u hapën punë në fshat, u hap stabilimenti i sharrave. Kështu u punësuan burrat e fshatit dhe jeta u përmirësua. U hapën dyqane dhe menxa punëtorësh. Rruga nacionale u përmirësua. U hapën edhe rrugë të reja në pyje dhe në fshatra. Kështu Stebleva u bë qendër e preferuar nga Peshkopia në Elbasan. Shpërngulje familjesh më shumë ka patur rreth viteve 60 sidomos në Tiranë, Durrës, Lac etj. Ka patur rreth 20 lindje në vit, 10 meshkuj dhe 10 femra. Vdekshmëria e foshnjeve ka qenë 8%. Vdekjet kanë

rreth tre në vit. Ciftet bënin nga 4-5 fëmijë. Martesat bëheshin pothuajse brenda fshatit, në moshën 20-25 vjeç. Para vitit 1967 fejesat bëheshin kryesisht me shkuesi, më pas edhe me dashuri. Në Steblevë nuk ka patur divorce. Divorcet nuk e kalonin masën 2%.

Shumë të bukura janë dasmat në Steblevë. Në ditën e dasmës nusja hyp në kalë të bardhë, dy të afërm e mbajnë në të dy krahët. Dhëndri prët në shtëpinë e tij. Flamuri kombëtar shqiptar ose bajraku sic e quajnë banorët prin në krye të dasmorëve e të krushqve. Orkestra shoqëron gjatë gjithë rrugës. Ajo zakonisht përbëhej nga Ramazan Kurti me curle nga Gjinovci, Isak Kurti nga Borova, Demir Kurti me daulle. E famshme ishte melodija: C'e ka zanë gjumi darën tek katër burimet e Steblevës. Lodrat sa nuk shpoheshin, por lëkura e dhisë nuk e ndjen aspak. Dasmat bëheshin kryesisht në vjeshtë sepse dasma ishte më e freskët dhe më e begatë me ushqime, fruta e perime, mish e bylmet.

Kërcimtar i hershëm dhe i talentuar ka qenë Sadik Murati, i cili luante dhe me dy kuklla në duar. Por jo më pak të talentuar Sali Gjini dhe Veli Bushati, të ndjekur më pas nga Shefqet Murati, Sami Kurti, Sali Hoxha, Emin Murati, Xhevat Lila, Dalip Murati, Ismail Gjini. Kërcimtarë në lëmin e dasmës janë të gjithë, por bukurinë ja shton edhe buka tradicionale e dasmës, zakonet dhe folklori i përsëritshëm, veshjet popullore të zonës, që nga corapet karakteristike deri tek shamija. Veshja e vajzave ndryshon nga ajo e grave. Vajzat kanë xhoke të bardha, nuset xhoke të kuqe. Gratë dhe vajzat i sheh me punë dore ndër duar.

Stebleva arriti deri në 190 shtëpi para vitit 1990, por pas këtij viti shumë familje u shpërngulën në Tiranë dhe gjetkë dhe në fshat kanë mbetur vetëm 15 shtëpi. Por tani vihet në një kthim në vendlindje dhe kjo na mbush me gëzim dhe krenari. Tani mungon zhurma e motorsharrave, por është thirrja e të parëve që na thërrret drejt vendlindjes. Nuk mund të lija pa përmendur dy dëshmorët e punës së fshatit tonë që ranë aksidentalisht duke punuar, Murat Muratin dhe Haxhi Kormakun. Për Steblevën, tani është koha të tregojmë se sa e duam atë.



Të shkruash për Xha Dylbinin është obligim e kënaqësi, bile edhe krenari, jo vetëm për mua që e kisha xhaxha, por për cilindo steblevas, shok, mik që e ka njohur nga afër atë.

Që në pamjen e parë të tij, veshur hijshëm, të impononte respekt, kulturë në çdo kohë, jo vetëm në punë, në shtëpi, po kudo që e takojë. Të bënte për vete me sjelljen e fjalët e tij, duke të pyetur me radhë për shëndetin, fëmijët e familjen etj. Gjithmonë gojë ëmbël e shumë i dashur. Siç ishte në

## (Njerëz që duhet të kujtohen) NJË EMËR QË NDERON STEBLEVËN

pamje i hijshëm, veshur bukur e me finesë, i tillë ishte edhe në profesionin e tij human të infermjerit, ndihmës mjekut.

Infermier ishte nga profesioni, por nga përkushtimi, dituria e sjellja e tij, korektësia e zotësia në punë ja kishte kaluar mjekut, prandaj në Steblevë, ku shërbeu gjithë jetën e tij i thoshin Doktor Dylbini. Dhe me të vërtetë doktor ishte, se të shëronte me dijet e

tij, me sjelljen dhe ëmbëlsinë e fjalës. Diagnozot që përcaktonte ai ishin të pa lëkundura, të sakta, kur verifikoheshin në spitale me aparaturat e kohës. Ndaj besimi i Steblevasve për xha Dylbinin ishte i pa lëkundur. Xha Dylbini nuk ishte vetëm një ndihmës mjek i përkushtuar, por edhe një aktivist i mirë dhe një familjar e prind i rrallë. Ai së bashku me gruan e tij rritën dhe edukuan

fëmijë të mirë, punëtorë, të dashur e të sjellshëm, kudo që jetojnë. Të flasësh e të shkruash për xha Dylbinin nuk i thua dot të tëra. Më shumë se kushdo i di populli i Steblevës, Borovës, Zabzunit e Sebishtit se nuk ka lënë shtëpi pa parë e njeri pa vizituar, qoftë në raste sëmundjesh, por edhe gëzimesh, në kohë të mirë e të keqe, ishte i gatshëm për t'i shërbyer komuni-

tetit. Njerëz që duhet të kujtohen e të respektohen nga brezat e rinj ka shumë Stebleva. Njerëzit duhet që ndonjëherë ta kthejnë kokën nga e kaluara, të vlerësojnë traditën e vyer të njerzve që nuk jetojnë, por që kanë lënë vlerën e dashurisë dhe respektit. Steblevasit sot janë njerëzit më të nderuar. Në Steblevë nuk ka gjakmarrje, nuk ka probleme pronash, në çdo takim ka kënaqësi dhe dashuri për njëri tjetrin.

Zaim Lila, Tiranë, 18 prill 2014

# KISHAT ORTODOKSE TË TREVËS SË GOLLOBORDËS

## (EMËRTIMET DHE KREMTIMET E FESTAVE FETARE)

Nga Pavli Nikolla

Shqipëria dhe treva e Gollobordës kanë qenë një nga vendet më të hershme të Europës që ranë në kontakt me krishtërimin. Ato kanë një histori të gjatë e të larmishme të besimit të krishterë. Sipas teologut Vasil Nasaj, i pari që ka predikuar Ungjillin në Shqipëri ka qenë vetë apostulli Pavli. Dihet se predikimin e Ungjillit e kanë sjellë apostujt Petre dhe Pavle. Në nderim të tyre në fshatin Tresance të Rekës është pagëzuar një kishë me emrin e këtyre apostujve.

Pas kësaj periudhe mori hov ndërtimi i kishave ortodokse në të gjithë Shqipërinë. Në këtë periudhë edhe në fshatrat e trevës së Gollobordës u ndërtuan një numër i madh kishash të emërtuar me emra shenjtorësh të ndryshëm, por më të zakonshëm dhe më të shumtat janë me emrat e shenjtorëve si: Shën Mëri, Shën Nikolla, Shën Gjergji, Shën e Premte. Nga 24 kisha të evidentuara dhe që njihen, emërtimet e tyre i kanë marrë nga emrat e këtyre shenjtorëve. Por, përvec këtyre kishave ka edhe me emërtime vendesh si "Fusha e kishës", "Na cirkov" etj. Sipas disa gojëdhënave numri i kishave në zonën e Gollobordës është më i madh.

Emërtimi i kishave me emrat e shenjtorëve të lartpërmendur shpjegohet me popullaritetin e tyre në popull, me sjelljen e tyre ndaj besimtarëve e me veprimtarinë e tyre bamirëse. Kështu p.sh. emërtimet e kishave Shën Mëri u përhapën shumë në mesjetën e vonshme jo vetëm si një barazvlerësim me shenjtorët meshkuj, por edhe për faktin se ajo njihet si nëna e Krishtit (Bogorodica). Emrin e saj e mbajnë kishat e Ostrenit të Madh dhe ajo e Tucepit. Jo më pak i rëndësishëm ka qenë Shën Nikolla. Ai është shenjtori ortodoks më popullor dhe ka qenë më i nderuari i shenjtorëve. Ai ka qenë peshkop në Azinë e Vogël në shekullin e IV, ndërsa në Greqi ai zuri vendin e përditës së detit. Me emrin e këtij shenjtori janë pagëzuar kishat e Steblevës, Gjinovcit dhe Ostrenit të Vogël. Shën Gjergji ka qenë një nga shenjtorët më popullorë, prandaj dita e Shën Gjergjit me 6 maj festohet nga të gjitha besim-

et. Ai njihet si luftëtar i mbretërve, mbrojtës i robërve. Emrin e këtij shenjtori mban kisha e Vërnices.

Në trevën e Gollobordës ka patur shumë kisha të bukura e të vjetra, monumente kulturi, që u shkatërruan barbarisht nga pushtimi otoman.

Kishat e Sebishtit, Steblevës, Trebishtit, Ostrenit të Madh, Tucepit, Lejcanit, Radoveshit etj u rrafshuan dhe bashkë me to shumë besimtarë lanë vatrat e tyre e morën arratinë nëpër vendet fqinje si Greqi, Bullgari, Maqedoni etj. Për hir të së vërtetës duhet thënë se popujt e këtyre vendeve i pritën me dashamirësi të shpërngulurit.

Goditjen tjetër kishat ortodokse të Gollobordës e pësuan gjatë regjimit që lamë pas, kur e emër të luftës kundër besimeve fetare u grabitën dhe u shkatërruan dhe ato pak kisha që kishin mbetur nga shkatërimi otoman.

Kështu u zhduk kisha e Shën Kollit në Ostren të Vogël dhe ajo e Shën Joanit në Pasinkë. Ndërsa kisha e Shën Nikollës në Gjinovc dhe ajo e Shën Gjergjit në Vërnice u grabitën dhe u kthyen në magazinë apo stalla të kooperativave.

Nga 24 kisha të regjistruara që kishte zona e Gollobordës sot ka 2 kisha të rikonstruara, ajo e Klenjës dhe Shën Ilija në Gjinovc dhe dy kanë mbetur si godina, Shën Gjergji në Vërnice dhe Shën Nikolla në Gjinovc. Këto të fundit nuk kanë as iconostas dhe as pajisjet e nevojshme për të ushtruar ritet fetare. Ndërsa kanë mbetur pa kishë besimtarët ortodoksë të Steblevës dhe të Pasinkës.

Për kishat e Steblevës ka shkruar edhe Prof. Dr. Milenko S. Filipovic, i cili në librin e tij "Gollobordo", botuar në Shkup në vitin 1940 thuhet: "Në fshat është kisha e Shën Nikollës, ndërsa në mal në përditës të fshatit është e shkatërruar kisha e Shën Spasit" (Ngritja e Krishtit në qiell), Shën Sotirit, Marko Dobica.

Aty është edhe varri i Pop Ngjele (1902). Në lindje të fshatit është vendi Markov Kamen si dhe burimi i ujit (Stefa Nedela). Burimi mendohet se ka ujë që ron disa sëmundje. Festa e fshatit

është Shën Nikolla (Sfeti Nikolla). Ndërsa pagëzimet janë bërë në Sfeti Spas. Kisha ka shërbyer edhe si manastir.

### Kremtimet dhe ritet

Dihet se kremtimet e ritet e festive fetare bëheshin mbi bazën e emërtimit të kishës. Në Steblevë, p.sh. festa fetare e ortodoksëve ishte Shën Nikolla. Ndërsa në fshatrat e tjerë festohej si ditë pushimi, në Steblevë festohej me rite të vecanta. Bëheshin gatimet më të mira sepse vinin miq nga fshatrat e tjerë, gatuanin bukë të zbukuruar të bekuar nga prifti dhe ndahej si përshpirtje, madje thuhet se në Klenjë dhe në Steblevë edhe myslimanët conin në kishë bukë të vecanta që shërbenin për ti ndarë midis fshatarëve. Në mëngjes shkonin në kishë dhe bëhej mesha në kujtim të shenjtorit Shën Nikolla e apostujve, bëheshin procesione rreth kishës e shkonin të festonin gjithë ditën në vende të tjera të shenjta si tek burimi me ujë shëruës. Në Steblevë festohej Shën Nikolla në verë, ndërsa në Ostren të Vogël festohej Shën Nikolla në dimër, i cili përkonte me kreshmat e Krishtlindjeve e gatimi ishte tjetër sepse nuk gatuhej gjellë me mish.

Të njëjtat rite kishin fshatrat që festonin të njëjtin shenjtor. Në Vërnice festohej dita e Shën Gjergjitsepse këtë emër kishte kisha, në Pasinkë Shën Joani e kështu me rradhë. Ka patur raste që kisha të fshatrave Ostreni i Madh dhe Tucep të festonin Shën Mërinë, por ë data të ndryshme, për shkak se festoheshin dy Shën Mari në data të ndryshme (Shën Maria e fjetjes dhe Shën Maria e ngritjes në qiell). Njëra festohej me 28 gusht në Ostren të Madh dhe tjetra me 21 Nëntor në Tucep. Këto quheshin Golema Bogodorica dhe Malja Bogodorica (Shën Maria e Madhe dhe Shën Maria e Vogël).

Sic u tha më sipër këto kremtime nuk bëhen më sot sepse në disa fshatra ku ende banojnë familje të besimit ortodoks sin ë Steblevë dhe në Pasinkë, nuk ka kisha ku besimtarët të kryejnë ritet e tyre, ndërsa në disa fshatra si në Ostren të Vogël dhe në Tucep nuk ka banorë të besimit ortodoks.

Kohët e fundit ka patur një debat për rolin e kishave

ortodokse dhe të besimtarëve të tyre.

Unë nuk kam ndërmend të komentoj mendimet e tyre, por më pëlqeu një reagim i shkrimtarit Sali Leka nga Selba e Tiranës, botuar në gazetën "SOT", të datës 13 nëntor 2012. Ai shkruan se disa autorë shkrimesh duke dashur të sulmojnë Kryepeshkopin Janullatus kanë fyer popullsinë ortodokse shqiptare.

Unë mendoj se Kisha Autoqefale Shqiptare nën drejtimin e Kryepeshkopit Janullatus ka ndihmuar dhe mund të them se ka bërë mjaft për rindërtimin apo rikonstruksionin e kishave ortodokse. Si kudo në Shqipëri dhe në zonën e Gollobordës ka dhënë ndihmën e saj. Kështu është rindërtuar kisha e Klenjës dhe është bërë rikonstruksioni i kishës së Shën Gjergjit në Vërnice.

Stebleva është një nga fshatrat ku besimtarët ortodoksë nuk kryejnë dot ritet e tyre fetare sepse nuk kanë kishë. Nga 5 kisha që ka patur më herët në Steblevë sot nuk ka asnjë. Atje banojnë 3-4 familje ortodokse ku në ditën e Shën Nikollës cohej bukë edhe nga myslimanët. Ky bashkëfestim sot nuk bëhet. Ndoshta do të ishte e nevojshme rindërtimi i

një kishë qoftë në themelet e së vjetrës, qoftë e një më të vogël në qendër të fshatit ku ka qenë kisha e Shën Nikollës.

Edhe në Pasinkë ku jetojnë 3 familje ortodokse nuk ka kishë. Ndërtimi i kishave apo rikonstruksioni i kishave të mëparshme egzistuese nuk duhet të trembë apo shqetësojë ndonjë gazetar apo publicist se na u shtokan kultet fetare. Edhe sikur të jetë kështu ato nuk dobësojnë bashkëjetesën midis feve të ndryshme, përkundrazi e forcojnë atë. Ne jemi dëshmitarrë se si është festuar me 2 gusht në kishën e Shën Ilias në Gjinovc, ku sëbashku ortodoksë e myslimanë festonin deri në mbrëmje vonë, apo edhe sot shkojnë së bashku në ditën e Shën Gjergjit në Steblevë.

Edhe në Herbel të Maqellarës banojnë tre familje ortodokse, por ë festimet e Shën Sotirit, që festohet cdo 19 gusht mbledhen e festojnë së bashku edhe besimet e tjera. Natën e 18 gushtit ata e kalojnë së bashku në kishë duke u mbështetur tek njëri tjetri.

Shpresojmë se së shpejti edhe Stebleva do të ketë kishën e saj ortodokse për besimtarët e saj ortodoksë.

## ORANIK!

Në emblemë dritësoje në muzeun e atëmadhit Ballëart qëndroje në të dytin rresht pas të shënjtit Të preka me duar, me sy të përkëdhela si bija e atit

E shkelur, e gjakosur betejash në shekuj nga thundra e tiranit. Toka ime e mpakur, e punuar me mund e me djersën e ballit, Në emër të përjetësisë përulëm të të ndjej, me duar të prek e të falem.

Sa shekuj kaluan Oranik, e bukura Zonjë ...ti hyjneshë e maleve Përtej një bote të pashkelur larg, shumë larg brigjeve. E mënjanuar, e heshtur, e braktisur, plagët e shekujve amove.

Krenare jam, kur shkel brazdave të punuara e të bleruar lëndinave Toka ime e rruhur, e punuar me mund e vaditur me djersë viteve Historinë gdhende në themelames të kalasë së gurtë.

Oranik e ngritur në ballë të diellit, rreze i lëshon historisë, Dielli në ballin tënd rreze i lëshon ardhmërisë. Jehon dhe sot oshëtima në nëntë malet e Dibrës Zëri i kryetrimt\*, në pikturat murale përjetojë historinë.

Nexhi BAUSHI

\* Beteja kryesore u bë më 20 maj 1456, në afërsi të Oranikut, (ORVENIK, STEBLEVE).

\*Moisi Golemi luftonte me trimëri të madhe.





# Meditime për Steblevën

FERIT BUSHATI

(Shkruar në gusht të vitit 1998)

Kur sajuam me lënë vatanin rrënjë dhe me shkuar në Tiranë, mbetën bjeshkët pa korrur thamë. Nuk i dihet, se si vjen puna, prandaj mirë do të bëjmë të shkojmë në mal, që të na gjindet, të marrim edhe ndonjë vërzomë bar.

Kështu një ditë vere, ditë gushti, me kosë në krah, hypur në kalë për herë të fundit u nisa në bjeshkë me korrur bar. Gjatë rrugës mes pyjeve të Mllaces, jo si më përpara kur pyjet ushtonin nga zërat e punëtorëve duarartë, nga motorsharrat dhe boritë e skodave dhe bjeshkët nga fyelli i barinjve dhe këmborët e bagëtive, por heshtje... Vetëm uji i përroit që gurgullonte. Aty këtu ndonjë zog cicëronte më tutje në mes të pyllit, aty ku qe ngritur dikur menxa e punëtorëve dhe ku guzhinjër xha Tafili na fronte të hanim mish dhe vezë bio. Një lepur i trembur vraponte dhe pas tij skilja që e ndiqte me të katra dhe që ndryshoi rrugën sapo na pa ne. Kështu shpëtoi edhe lepurit. Më lart në të dalë të pyllit tek burimi në shullan karshi diellit, bilbili këndonte. Këtu kali ndryshoi rrugë dhe shkoi drejt burimit dhe drejt bilbilit. Shkoi për me pi ujë dhe për me pi ujë më ftoi edhe mua. Pasi pimë ujë bjeshke nga rrëza e shkëmbit ku buronte dhe pasi pushuam pak, ashtu si mijëra të tjerë paraardhës të mi, ecëm drejt majës së bjeshkës aty ku bari qe rritur për korje. Një thëllëzë nëpër bar dicka kërkonte për zogjtë e saj që tua conte. E akoma më lart në majë të bjeshkës shqiponja përmbi fole mbi një gur krahëhapur qëndronte dhe dukej sikur për drekë na fronte... Është shkëmb, është rëpirë, s'ngjitemi dot, s'vimë. Zbritu poshtë në lëndinë se kemi marrë edhe për ty, bukë e gjizë. Por shqiponja nuk vinte,



folenë vetëm nuk e linte... Aty në një cast teksa kalitja kosën më pushtuan ndjenjat e dashurisë për vendlindjen dhe më erdhën natyrshëm vargjet e poezisë për këtë bjeshkë që na rriti, për këta njerëz që u lindën dhe u rritën në këto vise me borë e ujë të kristaltë. Natyrshëm më doli kënga nga gjoksi me zë të lartë, një këngë si vaje kurbeti...


Bjeshkë e male të Steblevës, sec janë mbledhë, po kuvendojnë  
Ikin njerëzit, ikin, ku po shkojnë ?  
Pas bekimin tua cojmë, se nuk shkon gjatë, do i kërkojnë...

bjeshka, ju prët Stebleva

Ju prët Stebleva me rrënjët e thella...

Unë e ndërpreva kangën, por hingëllima e kalit sikur më thoshte dhe më nxiste që të vazhdoja edhe më. Të vazhdoja të këndoja dhe të vazhdoja punën për kositjen e barit që e prisnin lopët në shtëpi. E sodita kalin në sy. Kjo kafshë besnike, nga më njerëzoret për njeriun sikur e kuptoi trishtimin tim për largimin nga bjeshkët. Eh, more kalë, more kalë flori, si do të rri unë pa ty, 50 vjet kam në këto rudina, mijëra vjet kanë të parët e mi... Shkuam së bashku në shtëpi, kali me bar, unë për bri tij. Po ndaheshim nga bjeshkët që kisha 50 vjet me to. Në shtëpi kali me tagjinë në govatën e tij sikur nuk kënaqej, unë me lakrorin me isla dhe me dhallë nuk po gjeja kënaqësi. Një fëmijë qesh me gjyshin që pi dhallë dhe e ngre me kusi për të shuar etjen. Ej, mor ti fëmijë, a e di se gjyshi bën shaka që ti ta kuptosh se etjen dhe dashurinë për vatanin nuk e shuan asgjë. ...Në vjeshtë, pa filluar mirë të ftohtit u nisëm për në Tiranë. Pas ca ditësh kur u shkri "dhjami" i fshatit fillova të kërkoj punë. Por se mos isha vetëm unë... Me qindra dhe me mijëra vetë si unë nga Stebleva dhe nga vise të tjera ishin larguar nga vatanin. Dikush më merr në telefon nga fshati dhe kërkon punë në Tiranë. Tiranën e duam, por i kemi hyrë në hak. Vrapim pas parasë na ka tjetërsuar. Në hak i kemi hyrë edhe tokës sonë. E kemi lënë djerr. ...Zëri i bjeshkës më thirri përsëri. Nisu bir... Por shtëpisë së lënë në dimër kishte filluar ti pikonte catia. Ajo kishte nevojë për meremetim. Mos më lër vetëm sikur thoshte ajo. U nisa përsëri në fshat akoma pa filluar mirë pranvera. Zemra dhe mendja ime vazhduan kështu duke u grindur dhe duke u pajtuar...

## Pamje nga Stebleva



Adresa e redakisë: Rruga "Xhon Belushi" Mbas Institutit të Fizikës Bërthamore, Vila Nr 519, Tiranë. Tel. 0695168173.

